



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:110463
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05573209

Ac.nr.3557/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.I.K. nga fshati Komuna e Malishevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.L., avokat në Pejë, kundër të paditurit D.E.D. nga fshati Komuna e Klinës, tani me vendbanim në Klinë, rr. “.....” pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K. avokate në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.636/17, datë 24.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit D.E.D. nga fshati Komuna e Klinës, tani me vendbanim në Klinë, rr. “..... pn., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.636/17, i datës 24.02.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.636/17, të datës 24.02.2020, ka vendosur që të Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.I.K. nga fshati Komuna e Malishevës, ashtu që detyrohet i padituri D.E.D. nga fshati Komuna e Klinës, tani me vendbanim në Klinë, rr. “..... pn., në emër të borxhit t'ia paguaj paditësit F.I.K. nga fshati Komuna e Malishevës, shumën prej 11.900 € (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind euro), me

kamatëvonesë vjetore prej 8%, duke u llogaritur nga dita e lidhjes së akt barazimit, me dt. 21.10.2014 e tutje, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1.214,20 €, e të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e autorizuar e të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe kërkesëpadinë ta refuzojë si të pabazuar, ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësit ka propozuar që Gjykata e Apelit ankesën e të paditurit ta refuzoj në tërësi të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj, duke i kërkuar edhe shpenzimet për përgjigje në ankesë në shumën prej 156 €.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 27.06.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, për shkak të borxhit, kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri D.E.D. nga fshati Komuna e Klinës, tani me vendbanim në Klinë, rr. "..... pn., që paditësit F.I.K. nga fshati Komuna e Malishevës, në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 11.900 € me kamatë në lartësi prej 8 % duke u llogaritur nga dita e lidhjes së akt barazimit me datën 21.10.2014 e tutje deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, e të gjitha në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.636/17, të datës 24.02.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara është jokontestues fakti se paditësi se bashku me disa punëtor të tij, i kishte kryer të gjitha punët artizanale (hollkera më gips), në objektin banesor "...." në Pejë, sipas porosisë së të paditurit. Gjithashtu për gjykatën nuk ka qenë kontestuese se i padituri me dt....paditësit për punët e kryera ia paguan shumën prej 4.500 €, ndërsa mbetet borxh për t'ia paguar edhe shumën prej 11.900 €, borxh të cilin nuk e kanë kontestuar as palët ndërgjyqëse gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pretendimet e palës së paditur se në bazë të akt barazimit të dt. 21.10.2014, obligimi për pjesën e pa paguar të borxhit prej 11.900,00€, i takon firmës ".....", pasi që edhe marrëveshja fillestare është krijuar në emër të kësaj ndërmarrje, për gjykatën është i pa bazuar, pasi që akt barazimi i dt.21.10.2014, nuk e ka formën e parashikuar me ligj, në mënyrë që detyrimi t'i takojë firmës "..... me seli në Klinë. Gjykata pas vërtetimit të gjendjes faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik - civil, i të paditurit ndaj paditësit për borxhin e papaguar, në shumën prej 11.900€, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij dhe si rezultat i kësaj për shkak të mos pagesës të borxhit, sipas punëve artizanale (hollkera më gips),

të kryera në objektin banesor “...” në Pejë, i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit. Gjykata dëshmisë së dëshmitarëve M.P., F.S., B.M. dhe deklarimit të paditësit F.K., ia fali besimin e plotë, pasi që janë bindëse për gjykatën, dhe janë në përputhje me njëra tjetrën. Gjykata e ka vlerësuar edhe deklarimin e të paditurit D.D. mirëpo të njëjtës nuk ia ka falë besimin pasi që ishte jo bindës për gjykatën dhe i një anshëm në deklarimin e tij.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 245 paragraf 1 të LMD-së, lidhur me nenin 7, 8, 143 paragraf 1 dhe 319 të LPK-së. Për kamatën gjykata i është referuar neneve 378, 382 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka mbështetur në nenin 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarës së të paditurit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2, pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, e posaçërisht nga deklaratimet e palëve ndërgjygjëse dhe nga deklarimi i dëshmitarëve, në mënyrë të pa kontestuar vërtetohet fakti se në këtë rast ekzistonte detyrimi civil-juridik i të paditurit ndaj paditësit në shumën prej 11.900€, për pagesën e borxhit, në emër të kryerjes së punëve artizanale në objektin banesor “...” në Pejë dhe se i padituri, gjatë procedurës kontestimore në shkallë të parë, me asnjë provë të vetme nuk ka argumentuar se raporti juridik është krijuar me subjektin juridik “.....”, përderisa nuk ka paraqitur asnjë provë materiale për të mbështetur këtë pretendim. Për më shumë, nga provat shkresore ka rezultuar se këtu i padituri pjesërisht e ka përmbushur detyrimin monetar ndaj paditësit ashtu që ka paguar një pjesë të borxhit sipas akt barazimit të nënshkruar me datë 21.10.2014, prandaj pretendimet për mungesën e legjitimitetit pasiv, sipas vlerësimit të gjykatës ankimore janë plotësisht të pabazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse në bazë të nenit 8 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit“, ndërsa me nenin 245 paragraf 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit, ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Si rezultat i kësaj, meqenëse i padituri nuk e ka përmbushur detyrimin, i njëjti ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar si

tërësisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e detyruar të paditurin që paditësit t'ia paguaj pjesën e mbetur të detyrimit si nga akt barazimi, në shumën e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Me aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur lidhur me kamatën e gjykuar, pasi që kamata është marrë në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 382 të LMD - së. Po ashtu, vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3557/20, me datë 04.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli